REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr._____Prot. Maliq, më 24.01.2025

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ
KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"* datë 17.12.2015, i ndryshuar, neni 53, *"Funksionimi i këshillit bashkiak"*, pika 4 dhe 5, neni 56 *"Kryetari i këshillit bashkiak"* pika 2 gërma "a", dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit Bashkiak Maliq miratuar me vendim këshilli nr.24, datë 12.03.2020, *"Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Bashkisë Maliq"* ju njoftojmë se mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Maliq do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të këshillit ditën e **premte, më datë 31.01.2025, ora 10:00** me këtë,

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
4.P-V "Për miratimin e buxhetit shtesë të bashkisë Maliq për vitin 2025";
5. P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin dhjetor 2024";
6.P-V"Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar mbi programin e bllok Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit, për vitin 2025'';
7. P-V "Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për familjet në nevojë, që do të trjatohen në Ndihmë Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2025'';
8. P-V"Për miratimin e kritereve, porcedurave, dokumentacionit, për përfitimin e Ndihmës Financiare dhe mbulimin e shpenzimeve të varrimit";
9-P-V "Për dhënie ndihme financiare për familje në nevojë";
10.P-V "Për vlersimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2026-2028";
11.P-V "Për miratimin e Deklaratës të Misionit dhe Vizionit të Bashkisë Maliq për peruidhën 2025-2029";
12.P-V "Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Rininë";
13. P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i qirasë për strehim";
14.P-V "Për miratimin e përfituesve nga programi subvencioni i intresave të kredisë për strehim";
15.P-V "Mbi përdorimin e fondit për projektin *"Shërbime mbështetëse dhe fuqizuese në familje për të moshuarit me aftësi ndryshe"* me financim të përbashkët nga Fondi Social i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Bashkisë Maliq";
16.P-V "Për dhënie Tituj Nderi";
17.Raport lidhur me vendimarrjen dhe performancën e Këshillit Bashkiak Maliq për vitin 2024.

18.Diskutime të tjera.

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si më poshtë:

Komisioni i Mirëqënies Sociale, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit, Drejtave të Njeriut. Pika 5, 6, 7, 8, 12 e rendit të ditës.
znj.Nersida Shindo, znj.Gentiana Drabo, z.Armando Dautllari, z.Plator Çollaku, znj.Marjeta Xhelollari.
Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjiktë Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare. Pikat 4, 9,10, 11, 15 e rendit të ditës.
z.Petrit Kupe, znj.Rudina Bregu, znj.Pranvera Begolli, znj.Eglantina Balli, z.Andonaq Risto

Komisioni i Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturës dhe Strehimit.
z..Idlir Limllari, z.Eriseld Jonusllari, z.Pranvera Begolli z.Almir Elezi z. Faslli Zholi, Pikat 13, 14 rendit të ditës.

Komisioni i Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Dhënies së Titujve, Emërtimeve. Pika 16 e rendit të ditës znj.Floreta Zaçe, znj.Daniela Ibarahim , z.Almir Elezi, z.Faslli Zholi, z.Server Xhuti

Ju faleminderit!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI